



REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. 2.D/DPK	Nr. Prot. Br. Prot. 01-4298/14
Nr. ftaq Broj stranica 02	Data Datum 20.11.2014
Nr. pages	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, nenit 18 (paragrafi 4, 8 dhe 12) të Ligjit nr. 04/L-051 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 20.11.2014 mori:

V E N D I M

I. Ekziston konflikti i interesit në ushtrimin e funksionit publik në rastin me nr. AKK -03-1700/14, për z. Viktor Mehana - Këshilltar Politik në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe njëkohësisht person i autorizuar në biznesin privat "KS TEAM" SH.P.K.

II. Agjencia do të kërkoj nga institucioni ku zyrtari i lartë ushtron funksionin që të filloj procedurën për shkarkimin e tij.

III. Agjencia do të kërkoj fillimin e Procedurës për Kundërvajtje nga Gjykata kompetente.

IV. Të gjitha vendimet që i nxjerr Agjencia lidhur me konfliktin e interesit bëhen publike në ueb faqen zyrtare të Agjencisë.

V. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

A r s y e t i m

I. Bazuar në Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik Nr.04/L-051 (në tekstin e mëtejme Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit), neni 18 (paragrafi 1 dhe 3), nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi, është inicuar rasti për zyrtarin e lartë Viktor Mehana i cili ushtron funksionin publik si: Këshilltar Politik në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe njëkohësisht është person i autorizuar në biznesin privat "KS TEAM" SH.P.K.

Fillimisht zyrtari i lartë është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit. Pas pranimit të kësaj shkrese, brenda afatit 15 ditor, z. Mehana është kontaktuar me zyrtarët e AKK-së. Ai është

njoftuar me faktet që posedon Agjencia për këtë rast, në lidhje me situatën mundshme të konfliktit të interesit.

Zyrtarit të lartë z. Mehana i është bërë e ditur se gjatë ushtrimit të funksionit publik si zyrtar i lartë, nuk mund të ushtroj funksionin e personit të autorizuar në biznesin privat "KS TEAM" SH.P.K. Kjo për faktin se Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit e ndalon një gjë të tillë.

Neni 15 (paragrafi 1) i këtij ligji shprehimisht thotë:

"Zyrtari i lartë nuk mund të jetë menaxher, anëtar i ndonjë organi menaxhues apo kontrollues i ndërmarrjeve private".

Bazuar në këtë dispozitë, Agjencia, përmes shkresës paralajmëruese, e ka njoftuar z. Viktor Mehana, se nuk mund të ushtroj këto dy funksione njëkohësisht dhe se duhet të zgjedhë njërin prej tyre. Për shmangien e konfliktit të interesit Agjencia i ka dhënë një afat shtesë, mirëpo, z. Mehana nuk e ka përfillur këtë afat dhe deri më sot nuk është larguar nga njëri prej funksioneve.

II. Agjencia do të kërkoj nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale që të filloj procedurën për shkarkimin e tij. Kjo bazuar në nenin 18 (pika 8) të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit i cili thotë: *"Në rast se personi zyrtar i lartë vazhdon të kryej aktivitete apo funksione të papajtueshme sipas këtij ligji, pavarësisht nga paralajmërimi i Agjencisë, atëherë Agjencia i kërkon institucionit ku zyrtari i lartë ushtron funksionin që të filloj procedurën për shkarkimin e tij".*

III. Sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, neni 20, pika 1, *"Çdo shkelje e detyrimeve të përcaktuara me këtë ligj, kur nuk paraqet vepër penale, paraqet kundërvajtje dhe dënohet me gjobë sipas kufijve të përcaktuar në paragrafin 1.1, 1.2 dhe 1.3".*

Sipas Nenit 20 pika 2, *"Për shkelje të detyrimeve të përcaktuara me këtë ligj, zyrtarit të lartë publik, udhëheqësit apo drejtuesit të institucionit udhëheqës, përveç dënimit gjykata mund t'i shqiptoj edhe masën mbrojtëse; ndalimi i ushtrimit të funksionit publik në kohëzgjatje prej tre (3) muaj deri në një (1) vit".*

IV. Sipas Nenit 18 paragrafi 12, të gjitha Vendimet që i nxjerr Agjencia lidhur me konfliktin e interesit bëhen publike në ueb faqen zyrtare të Agjencisë.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./ znj. (zyrtari ndihmës)

Hasan Preteni
Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit

